



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 29 korrik 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N- 303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kaçiu, praktikante, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: ministri i Ministrisë së Integrimeve Evropiane z. Bekim Çollaku, drejtori i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni, (Qëndresa Mulaj, Ilir Abazi, Valbon Bytyçi, Fatlinda Ramosaj, Ibrahim Gylden) – ZAP, (Tringa Bytyçi, Kaltrina Ahmeti) – GLPS, Sanije Berisha – OSBE, Rejhane Zylfijaj – GIZ, Elhami Dobra – KK, Besa Maliqi – TV Tribuna, Lumturie Beka – Kosova.info dhe Gita Lushi – TV Rrokum.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv.kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.7.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. I ftuar ministri i MIE-së, z. Bekim Çollaku dhe zëvendës auditori i Përgjithshëm, z. Artan Venhari;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare. I ftuar drejtori i Policisë së Kosovë z. Shpend Maxhuni;

5. Të ndryshme;

Rend i ditës:

Zv.kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.7.2015;

Zv.kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.7.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;

Zv. Kryetari i përshëndeti të pranishmit dhe ia dha fjalën auditorit për të gjeturat e raportit të auditimit, për pasqyrat vjetore financiare të MIE-së.

Ilir Abazi- Opinioni i auditimit për MIE-në është opinion i pamodifikuar. Realisht pasqyrat tregojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përjashtim të shpalosjes së pasurive, kjo është një prej çështjeve, tregon një shpalosje jo të drejtë të pasurive kapitale, e cila është kategorizuar si pasuri jokapitale, një çështje tjetër që është ngritë ka të bëjë me procesin e adresimit të rekomandimeve, vitin paraprak realisht në vitin 2013, kanë qenë 9 rekomandime. Ne e kemi shqyrtuar adresimin e tyre dhe kemi arritur në përfundim se gjysma e tyre janë implementuar, një është në proces dhe katër tjera mbeten për tu adresuar. Rekomandimet të cilat nuk janë implementuar kanë të bëjnë me planifikimin e buxhetit për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, për rezervimin e biletave, për ndarjen e subvencioneve dhe monitorimin e implementimit të tyre si dhe menaxhimi i pasurisë fikse. Çështja e planifikimit të buxhetit, planifikimi nuk ka korresponduar realisht me atë çka është realizuar gjatë vitit 2014, e ka një mosbalancim, ne i kemi shqyrtuar dhe i kemi analizuar, ministria për vitin 2015 e ka bërë një analizë, duke u bazuar në parametrat e vitit paraprak, mirëpo, për vitin 2014 realisht ka mbetur si çështje e paadresuar. Një çështje tjetër që e kemi ngritë është edhe shfrytëzimi i biletave të “biznes klasit”, kemi gjetur dy raste, ku nuk janë shfrytëzuar biletat e klasës ekonomike por janë shfrytëzuar biletat e klasit të biznesit, nuk kemi gjet një arsye pse është bërë ai shfrytëzim i biletave.

Një çështje tjetër ka të bëjë me dhënien e subvencioneve, përkatësisht me implementimin dhe monitorimin e tyre, subvencionet janë shpërndarë nga ministria, kanë qenë fillimisht të analizuar prej komisionit dhe komisioni i ka vlerësuar se nuk janë brenda fushës së veprimtarisë së ministrisë, pavarësisht kësaj subvencionet janë dhënë dhe janë financuar.

Çështje tjetër është menaxhimi i pasurisë. Janë vërejt disa mangësi në këtë fushë, si regjistra rreth pasurive, pajisjet zyrtare, thjesht përgjegjësi në menaxhimin e përditshëm të pasurisë.

Bekim Çollaku- MIE në bazë të mandatit koordinon procesin e integritetit të vendit, duke pasur rol koordinues. Ministria ka një buxhet shumë modest, është në vlerë diku rreth 1.8 milion dhe ka një staf relativisht të vogël, nëse krahasohet me ministrinë tjetër, diku rreth 85 zyrtarë. Në vitin 2014 është punuar së bashku me ZAP-in për përgatitjen e raportit të auditimit për pasqyrat financiare. Raporti ka treguar se pasqyrat financiare të MIE-së paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, njëkohësisht raporti ka evidentuar disa rekomandime për përmirësimin e mëtutjeshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm brenda ministrisë. E tha edhe auditori se raporti i auditimit për vitin 2014, ka konstatuar nëntë rekomandime të bëra për raportin e vitit 2013, edhe ato katër janë zbatuar, një rekomandim është në proces të adresimit, ndërsa katër rekomandime tjera do të adresohen brenda mandatit tim. Me pranimin e draftit të ndërmjetëm të raportit të auditimit në muajin shtator 2014, MIE-ja ka filluar ti adresoj të gjitha rekomandimet e ZAP-it dhe njëkohësisht kemi përgatitur edhe një plan të veprimit për adresimin e rekomandimeve të mbetura. Në këtë drejtim janë bërë korrigjime të nevojshme për paraqitjen e drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare dhe regjistrimit të pasurisë, konform ligjit të prokurimit publik, është ndërprerë emërimi i zyrtarit të prokurimit si menaxher i kontratës, është përmirësuar planifikimi buxhetor, në fushën e subvencioneve është hartuar një rregullore e re e brendshme e ministrisë, e cila ka për qëllim përmirësimin e mekanizmave të mbështetjes së organizatave joqeveritare, po ashtu ka filluar raportimi i rregullt mujor për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare të Ministrisë së Administratës Publike, njëkohësisht me qëllim të rritjes së efikasitetit të kontrollit të brendshëm, gjatë pjesës së parë të vitit 2015, auditori ynë i brendshëm ka audituar dy fusha, menaxhimin e pasurisë dhe procesin e buxhetit, me qëllim të përmirësimit të sistemeve tona menaxhuese.

Adem Grabovci- Ne kemi marrë raportin e auditorit të përgjithshëm. Në fillim dua të shpreh kënaqësinë time se kemi disa të gjetura që krahasuar me ato të mëhershmet janë të nivelit shumë më të vogël, që japin me kuptua që puna, aftësimi dhe përgatitja e përfaqësuesve tonë institucionalë është duke u zhvilluar me sukses. Nga raporti kemi disa të gjetura, ku nëntë sa kanë qenë gjithsej, pothuajse vetëm katër kanë mbetur të paadresuara dhe unë nuk dyshoj aspak në zotimin e ministrit dhe angazhimin e tij, se këto do të adresohen dhe do të korrigjohen. Në anën tjetër, me gjithë respektin për punën e auditorit, disa të gjetura kanë qenë më shumë teknike, që kanë të bëjnë me adresime të gabuara. Mjetet e planifikimit i buxhetit, unë mendoj që edhe auditori, edhe ne duhet ti kemi parasysh se disa organizata buxhetore i kanë specifikat e tyre, dhe ne kemi disa zbrazësi ligjore dhe këtë çështje dhe se nuk e kemi mirë të rregulluar me ligj, këtu të shpenzimet jashtë vendit që thuhet se është një tejkallim që ka ndodhur, mirëpo unë mendoj se është e njëjta natyrë e punës, se nëse kemi tejkallim në njërin, kemi një kursim të jashtëzakonshëm në tjetrën.

Bali Muharremaj- Shihet se në këtë ministri sa i përket raportit të auditimit të vitit 2014, ka pasur shkelje dhe këto shkojnë të gjitha në dëm të taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Në rend të parë nuk është bërë një planifikim i mirëfilltë për shpenzimet për një vit që shpenzon MIE-ja.

Ministër, si ka mundësi që një punëtorë ka marrë pjesë në një komision, edhe paratë i ka marrë pra në pushim të lehonisë dhe ka marrë edhe shtesë? Si ka mundësi të planifikohen 210.000 euro për udhëtime zyrtare dhe të kalojnë në 410.000 euro? Si ka mundësi asistentja e ministres të nënshkruajë faturë mbi 1.500 euro?

Duda Balje- Siç mund të shohim, nuk ka shumë dallim të madh raporti i auditorit të vitit 2014, në krahasim me raportin e auditorit të vitit 2013. Pra çdoherë ka planifikim të ndryshëm të buxhetit, nga ajo se çka është shpenzuar. Cilët janë hapat konkret, pra a keni ndërmarrë diçka konkrete në lidhje me këtë çështje dhe me stafin që ka qenë pjesë e këtyre keqpërdorimeve?

Hajdar Beqa- Unë shoh se ka përmirësime nga viti në vit, por unë do të ndalem pak te personeli, të ketë një kontroll më të fuqishëm të lëshimet e procedurave administrative. U tha të pushimi i lehonisë, juridikisht nuk është e pranueshme që një zyrtar të jetë në pushim dhe të thirret në komisionet përkatëse dhe mendoj që ministri do të marrë masat e duhura. Në të njëjtën kohë, i kemi edhe rastet e fituesve të bursave, ku në marrëveshjen që është në mes të ministrisë dhe përfituesit, në këtë rast është obligim ligjor që pasi të kryhen studimet të kthehet dhe të jep një kontribut për ministrinë për tre vite, ku në bazë të të gjeturave të auditorit nuk është realizuar kjo.

Zv. kryetari- Mendoj se kemi të bëjmë me shqyrtim të një raporti jo të mirë. Këto të gjetura janë në kohën kur ju nuk e keni udhëhequr këtë ministri, por gjithsesi këto janë të gjetura që flasin për realitetin e Kosovës. Fjala e juaj për mua ishte inkurajuese, sepse më jep të kuptojë se ju e keni kuptuar seriozitetin e çështjes dhe se para vetes e keni shtruar një plan të veprimit.

Bekim Çollaku- Unë edhe njëherë e shtroj zotimin tim, se të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga raporti i auditimit, do të adresohen në mënyrën më korrekte të mundshme. Fakti që unë nuk kam qenë ministër 2014-2013 nuk më arsyeton, sepse tani e kam marrë udhëheqjen e ministrisë dhe të njëjtët njerëz që kanë punuar në ato vite, vazhdojnë të punojnë dhe tani dhe unë nuk do të tolerojë që gabimet e njëjta të përsëriten nga viti në vit.

Zv. Kryetari pyeti të pranishmit se a kanë diçka tjetër për të shtuar. Pasi që nuk pati të interesuar për të diskutuar, e hodhi në votim propozimin, që raporti i Auditimit për PVF-në e Ministrisë së Integritetit Evropiane, të adresohet për diskutim në seancë plenare, bashkë me rekomandimet e dala nga takimi i KMFP-së.

Përfundim

Komisioni vendosi njëzëri që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, të adresohet për seancë plenare, së bashku me rekomandimet e KMFP-së.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve zyrtare;

Zv.kryetari e hapi diskutimin për këtë pike të rendit të ditës, duke ja dhënë fjalën udhëheqësit të ekipit nga ZAP-i, i cili e ka bërë hartimi e raportit të auditimit.

Fatlinda Ramosaj- Disa mangësi që ne i kemi vërejtur për policinë e Kosovës, janë mosanalizimi i duhur i nevojave, PK-ja e mban një regjistër për shpenzimet të cilat i bën për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, mirëpo, nuk e kishte bërë identifikimin dhe vlerësimin e nevojave bazuar në ato të dhëna. Vlerësimi jo i duhur i nevojave ka sjellë edhe mangësi tjera, siç është përdorimi i shpeshtë i procedurës së kuotimit të çmimeve, Policia e Kosovës në vitet 2011-2013, pati lidhur 159 kontrata vetëm për këto shërbime. Nuk kemi hasur ndonjë kriter të gabuar, mirëpo duhet pasur parasysh që procedura e kuotimit të çmimeve nuk është procedurë transparente dhe as nuk ofron konkurrencë dhe rrjedhimisht as çmime më të mira. Te PK-ja është e pamundur që të nxjerrën kursime të mundshme, për arsye të numrit të madh të kontratave, mirëpo çmimet kishin dallime të mëdha me çmimet e tregut dhe me organizatat e tjera buxhetore në disa artikuj. Ato që i kemi marr si mostër, ishin 2-3 herë më të shtrenjta se çmimet e tregut.

PK-ja ka pasur dhe një dobësi, se vetëm në vitet 2011-2013, në disa lloje të automjeteve, vlera e riparimeve tejkalon vlerën e blerjes, e edhe kur nuk e tejkalon është shumë e madhe. Ne e kemi marr edhe çmimin e tregut, sa do të mund të ishin sot ato automjete dhe çmimi mesatar vetëm për tre vite tregon se do të mund të blinin diku 39% të automjeteve. Si dhe dobësi tjetër është flota operative, ku shumë pajisje nuk janë funksionale. Aparati i saldimit, pajisja e autolarjes, regllazha, pra janë shpenzime të panevojshme.

Zv. kryetari- Në një raport të vitit të mëparshëm, ne kemi parë se policia e ka njësinë e servisimit të veturave të instaluar me shuma të mëdha të mjeteve, qoftë nga buxheti i Kosovës apo donacionet. Kjo është edhe më keq, kur donatorët kanë dhënë mjetet e tyre për servisim, e në raport shihet se asnjë automjet nuk është servisuar në ato qendra. Ky servisim është bërë jashtë dhe është bërë më kuotim të çmimeve. Pastaj pjesët që janë instaluar nëpër automjete, janë më të shtrenjta se çmimi më i lirë. Këto janë disa çështje që janë mjaft shqetësuese zoti drejtor, p.sh. në vitin 2011, ju keni pasur 1,358 automjete, në vitin 2012, keni pasur 1,400 dhe në vitin 2013, ju keni pasur 1,432 automjete. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme, ngritja e një qendre për servisim brendapërbrenda Policisë së Kosovës.

Shpend Maxhuni – Sa i përket raportit të auditimit, që i referohet shpenzimeve që janë bërë për riparimin e veturave në Policinë e Kosovës, besoj që është e njohur cili është obligimi dhe përgjegjësia e Policisë së Kosovës në raport me sigurinë e vendit dhe obligimeve që i kërkojnë ligjërisht. Sipas vlerësimit që Policia e Kosovës e ka, janë procedurat e prokurimit të cilat e pamundësojnë realizimin e një projekti, sipas parashikimeve që ka, çdo institucion në rastin konkret PK-ja. Ne për çdo vit fiskal, bëjmë planifikimin e nevojshëm. Rasti konkret, ne kemi buxhet të ndarë për blerjen e veturave të reja, por që nga viti 2009, ne nuk kemi qenë në gjendje të realizojmë projektin për blerjen e këtyre veturave të reja, konkretisht në segmentin që ne është dashtë të investojmë për riparimin e veturave. Ne po ashtu e kemi raportin e statistikave për shpenzimet që i kemi bërë. Unë vlerësoj që këtu nuk është diçka në rregull, sepse shpenzimet e

Policisë së Kosovës nuk janë shpenzimet më të mëdha për ato pjesë. Sa i përket vërejtjeve të apostrofuara në raportet e viteve të kaluara, ato janë implementuar diku rreth 80% nga Policia e Kosovës. Tashmë të gjitha mjetet e PK- së janë menaxhuar në aspektin e riparimit dhe të mirëmbajtjes në Flotën Operative të Policisë së Kosovës. Por, disa nga prishjet specifike që kanë ndodhur në makinat e PK- së, është dashtë që për ato prishje të kontraktohen jashtë përgjegjësisë që e ka Flota Operative e PK- së, për vetë faktin se ka munguar ekspertiza e nevojshme nga njerëz që punojnë brenda flotës, pra po flasim për një pajisje që është Alfa dhe Omega e punës së Policisë së Kosovës.

Sa i përket vërejtjeve për mbajtjen e evidencave për servisimin e pjesëve të veturave, respektivisht pjesëve të hekurta, ne kemi trashëguar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, një softuer i cili nuk jep aq mundësi për ta menaxhuar çështjen e evidentimit. Por, në vitin e kaluar kemi pranuar një donacion nga Ambasada Amerikane, që do të ndihmojë PK- në, në çështjen e evidentimit të ndërrimit të pajisjeve të veturave. Ky sistem ka filluar funksionalizimin dhe besoj që nuk do të kemi probleme, sa i përket mbajtjes së evidencave për riparim të veturave që menaxhohen nga Flota Operative e Policisë së Kosovës.

Sa i përket kontrollit teknik, ne kemi marrë pëlqimin nga Ministria e Infrastrukturës për hapjen e qendrës për kontrollim teknik për automjetet e PK-së, mirëpo për marrjen e licencës nga Ministria e Infrastrukturës, është kërkuar nga Policia e Kosovës që të ndërtojë një objekt konform rregullave dhe standardeve, natyrisht edhe sipas udhëzimit administrativ 2008/13 dhe në këtë fazë ne jemi duke bërë identifikimin e një lokacioni të mundshëm për këtë objekt.

Bali Muharremaj – Ne si Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e kemi për obligim që ta ruajmë paranë e taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Ne po flasim në bazë të raportit që ka dalë nga Auditori i Përgjithshëm. Kanë qenë shtatë rekomandime, prej këtyre rekomandimeve vetëm një rekomandim është adresuar, katër janë në proces të implementimit dhe dy nuk janë adresuar fare.

Çka është duke ndodhur me 268 vetura, që janë në servisim që nga viti 2009? Gjithashtu te lloji i veturës Toyota Land Cruiser janë 120. Vlera e blerjes është 21,000 euro, kurse shpenzimet për riparim për tre vite ka kushtuar sa me e ble një veturë të re.

Naim Fetahu – Ne e dimë rëndësinë dhe rolin e PK-së. Ne jemi duke kërkuar të dimë arsyen e mosplotësimit të rekomandimeve. Gjithashtu ne kemi pasur më herët një vendim të qeverisë, që të kursejnë për mosblerjen e automjeteve të reja dhe kjo ka vendosur në një pozicion jo të kënaqshëm edhe policinë, edhe institucionet tjera. Megjithatë, mendoj se duhet ti kushtohet një kujdes më i madh çështjes së shpenzimeve të flotës së automjeteve të policisë, një kontroll më i madh në këtë drejtim. Gjithashtu kemi edhe disa lëshime të menaxhimi i burimeve njerëzore. Kemi disa njerëz që e kalojnë afatin kohor si ushtrues detyre, por gjithsesi presim nga Policia e Kosovës rezultate më të mira.

Shpend Maxhuni- Sa i përket çështjes së 268 veturave, që vlerësohet që janë për servisim, ne kemi vlerësuar se ato vetura janë për shitje dhe jo për riparim. Ne kemi qenë të detyruar që të bëjmë të mundur kthimin në funksion të atyre makinave, për të përmbushur misionin që e ka Policia e Kosovës. Ne duhet të bëjmë analiza dhe vlerësime, të cilat do të na mundësojnë si institucion, që të mos vijmë në këtë gjendje.

Sa i përket pyetjes të zyrtarëve që janë ushtrues detyre, edhe kjo në një mënyrë apo tjetrën, lidhet me specifikat që i ka Policia e Kosovës. Ne e kemi trajtuar në vazhdimësi këtë çështje, por ja që nevojat operacionale na kanë imponuar që ne në periudha të caktuara, në pozita të caktuara, të kemi zyrtarë policorë me atë kapacitet dhe në funksion të ushtruesit të detyrës. Vitin e fundit kjo çështje është menaxhuar shumë mirë dhe në PK- së janë vetëm 26 funksione në pozitën si ushtrues detyre dhe është fillimi i muajit të ardhshëm, ai i cili do të përcaktojë të gjitha pozitat në kuadër të PK-së, siç e parasheh ligji për udhëzimin administrativ.

Dua t'ju sigurojë që me përgjegjësinë dhe sinjeritetin më të madh, ne i përcjellim të gjitha obligimet dhe detyrat e të gjitha strukturave të PK- së. Jemi munduar që të bëjmë analiza që i referohen analizave të nevojshme në PK- së, flota operative është një makth për PK- në, sepse nuk është dëshmuar që është modeli më i mirë i ekzistimit të këtij koncepti brenda policisë. Kjo flotë ka qenë e kontraktuar jashtë shërbimit të policisë dhe ka funksionuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Duhet të mendojmë në mënyrë kreative, se a duhet ti ketë PK-ja këto shërbime brenda vetes, apo duhet të shkojë dhe të përfillë modelet siç i kanë policitë e rajonit dhe e Evropës.

Zv. kryetari- Si pikë tjetër, ne e kemi edhe raportin e rregullsisë për PK- në, për arsyetim të raportit fjalën e ka përfaqësuesi nga ZAP-i.

Valbon Bytyçi- Sfidat të cilat kanë dalë nga auditimi në raportin e rregullsisë veç u përmendën. Çështjet kryesore kanë qenë, veturat në pritje për servisim, mbulimi i pozitave me ushtrues detyre dhe adresimi i rekomandimeve. Dëgjuam nga drejtori i PK- së shpjegimet rreth këtyre sfidave, dëgjuam për planet të cilat do të adresohen dhe progresin që është arritur deri me tani, kështu që elementet që kanë dalë nga raporti i rregullsisë veç u mbuluan.

Shpend Maxhuni- Si çdo institucion tjetër, edhe ne bëjmë planifikimin për vitin fiskal, tani tek Drejtoria e Financave dhe te buxheti në përgjithësi. Është e vërtetë që kemi ngecje në realizimin e projekteve, kryesisht në investimet kapitale. Shumica e nevojave për këtë vit ndërlidhen me ndërtimin e objekteve të PK-së. Ne, më 14 janar të këtij viti e kemi dorëzuar kërkesën tonë siç e përcakton ligji në instancat kompetente, për ta aprovuar listën e pajisjeve për shërbime të veçanta për PK- së dhe kanë kaluar disa muaj dhe ajo listë nuk është aprovuar.

Sa i përket vonesave për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve, edhe këtu kemi të bëjmë me pronësinë e objekteve, hapësirave ku ne synojmë të ndërtojmë objektet.

Përfundim

Raporti i Auditimit të Performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e veturave zyrtare, bashkë me Pasqyrat Vjetore Financiare të PK- së, KGJK- së, MAP- it dhe Doganës, do të adresohen për seancë plenare bashkë me rekomandimet e dala nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ndërsa, raporti i Auditimit të Performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e veturave zyrtare për ATK- në, që ishte pjesë e këtij raporti të auditimit, nuk do të adresohen për seancë plenare.

5. Të ndryshme

Zv. kryetari njoftoi deputetët dhe të pranishmit, se në këtë pikë do të diskutohet lidhur me hapat që janë ndërmarrë nga Administrata e Kuvendit, në lidhje me adresimin e çështjes për auditimin e raporteve financiare dhe të fushatës për subjektet politike. Ka një kategorizim në mes të auditorëve ligjorë dhe auditorëve të licencuar ligjorë dhe me këtë e hapi edhe diskutimin.

Synavere Rysha – Auditorë të certifikuar janë quajtur auditorët që punojnë brenda institucionit, kurse auditorë të licencuar janë auditorët që punojnë jashtë institucionit. Auditorët në institucione nuk kanë të drejtë që të kryejnë auditim të atyre institucioneve, ndërsa auditorët e licencuar, kanë të drejtë të bëjnë auditim të subjekteve politike.

Mentor Hyseni – Partitë politike auditohen prej auditorëve të jashtëm, që janë të licencuar nga një shoqata brenda apo jashtë shtetit. Dallimi në mes auditorëve ligjorë dhe auditorëve të licencuar është se, auditori i licencuar pas një praktike trevjeçare në mbikëqyrjen e auditorit ligjor, e merr të drejtën që të bëhet auditor ligjor. Auditori i licencuar ka të drejtë të bëjë auditimin e pasqyrave financiare të OJQ-ve, që kanë një buxhet të limituar, kurse auditori ligjor ka të drejtë që të bëjë auditimin edhe me shuma më të larta, dhe të auditojë edhe organizata tjera, kështu që auditori ligjor është nivel më i lartë se auditori i licencuar.

Kaltrina Ahmeti – Auditori ligjor është shumë më i avancuar se auditor i licencuar. Një auditor ligjor nuk mund të bëhet auditor ligjor, fillimisht pa qenë auditor i licencuar. Arsyeja pse një auditor ligjor është më i avancuar se një auditor i licencuar, është se shumat që i nënshkruan një auditor ligjor, janë shumë të mëdha, në krahasim me shumën që nënshkruan një auditor i licencuar. Pasi që është fjala për auditim të subjekteve politike, atëherë ne kemi propozuar që me qenë auditor ligjor në kritere.

Naim Fetahu – Auditimi i subjekteve politike është një fushë shumë e ndjeshme që të gjithë ne e dimë. Ne duhet ta kemi parasysh se tash tri herë është bërë shpallja e tenderit dhe kriteret kanë qenë aq të larta, sa që nuk i ka plotësuar asnjë klient. Mendoj se nëse ne punojmë në këtë drejtim duhet t'i zbresim pak kriteret që të mund të bëjmë auditimin.

Kaltrina Ahmeti- Unë e kam shumë të qartë, se deri tani është shkuar me procedurë të tenderit, për atë arsye mendoj se duhet të shkohet me kontratë mbi vepër. Në këtë mënyrë ju do të mund të gjeni auditorë, të cilët i plotësojnë kriteret. Sa i përket plotësimit të kriterëve, e kemi parasysh se nuk kemi shumë auditorë ligjorë, por grupi për studime politike dhe juridike ka bërë këtë propozim, që të krijohen ekipe, ku duhet të jetë patjetër një auditor ligjor dhe disa auditorë të licencuar, kështu që një raport që del nga një ekip i

caktuar të ketë mundësi të shikohet prej një auditori ligjor, në mënyrë që në të ardhmen mos të ketë një palë tjetër që të mund ta sfidojë vlefshmërinë e këtij raporti.

Përfundim

Komisioni njëzëri vendosi që të formohet grupi i punës në përbërje prej Synavere Rysha, deputete, Hajdar Beqa, deputet, Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ- i dhe Kaltrina Ahmeti- GLPS, (që të përgatisin një raport, për të përcaktuar mënyrën dhe kriteret për përzgjedhjen e auditorëve të licencuar për auditimin e raporteve financiare dhe të fushatës së subjekteve politike).

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.
E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu